

RAPORTIM PERIODIK

STRATEGJIA INSTITUCIONALE 2022 – 2025

Strategjia Institucionale 2022-2025 (në vijim “Strategjia”) e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) identifikon vizionin dhe misionin e Zyrës së Komisionerit, objektivat për secilën fushë, si dhe masat e aktivitetet konkrete që do të realizohen në këtë periudhë.

Strategjia shoqërohet gjithashtu nga Plani i Veprimit 2022-2025, i cili shërben si një instrument programimi dhe monitorimi i aktiviteteve për përmbushjen e çdo objektivi të parashikuar në këtë Strategji.

Përmbushja e tyre ka si qëllim rritjen e nivelit të ushtrimit në praktikë të të drejtave kushtetuese nëpërmjet zbatimit të standardeve më të larta rregullatore në fushën e të drejtës për informim dhe atë të mbrojtjes së të dhënave personale.

Vizioni i Zyrës së Komisionerit është promovimi i një shoqërie që mban si vlera thelbësore garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtës për informim, në funksion të transparencës, përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies.

Misioni ynë është monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të kuadrit ligjor për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave në epokën digjitale duke nxitur autoritetet publike dhe kontrolluesit publikë e privat në ndërtimin e besimit reciprok me qytetarët, i cili sjell përmirësimin e mentalitetit dhe kulturës së shoqërisë në respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në këtë Strategji janë parashikuar objektiva konkret e të realizueshëm, të cilët shkojnë në përputhje jo vetëm me akte kombëtare (Kushtetuta, legjislacioni në fuqi, Rezolutat e Kuvendit, Strategji ndërinstitucionale, etj), por edhe me rekomandimet e dokumenteve evropiane dhe/ose ndërkombëtare, si dhe në përputhje me nevojat e konstatuara gjatë zbatimit në praktikë të legjislacionit në fuqi.

Strategjia është hartuar duke marrë në konsideratë kuadrin ligjor ekzistues dhe procesin e modernizimit të tij në të dy fushat e përgjegjësisë dhe parashikon 4 objektive madhor për secilën fushë përgjegjësie.

Konkretisht, për fushën e së drejtës së informimit janë parashikuar objektivat si më poshtë:

- **Objektivi 1:** Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e të drejtës për informim në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- **Objektivi 2:** Komunikimi proaktiv për konsolidimin e kulturës së transparencës të autoriteteve publike;
- **Objektivi 3:** Bashkëpunimi me qytetarët dhe grupet e interesit për njohjen e kuadrit të modernizuar ligjor dhe rritjen e ndërgjegjësisë me qëllim zbatimin efektiv të tij;

- **Objektivi 4:** Zhvillimi dhe zgjerimi i marrëdhënieve ndërkombëtare brenda komunitetit global rregullator të të drejtës për informim.

Në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale objektivat kryesorë për këtë periudhë janë:

- **Objektivi 1:** Arritja e standardeve më të larta rregullatore për të forcuar mbrojtjen e të dhënave personale në epokën digjitale;
- **Objektivi 2:** Rritja e kapaciteteve institucionale në kuadër të përmirësimeve ligjore, me fokus të veçantë sistemet e sigurisë së menaxhimit të informacionit (SMSI);
- **Objektivi 3:** Rol aktiv në ndërgjegjësimin dhe promovimin e të drejtave të qytetarëve me fokus, edukimin e brezit të ri;
- **Objektivi 4:** Forcimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë për shkëmbimin e përvojave më të mira, me fokus risitë që sjell zbatimin i legjislacionit të harmonizuar.

Në përputhje me Regulloren e Brendshme të Zyrës së Komisionerit procesin e monitorimit të zbatimit të Strategjisë Institucionale 2022-2025 dhe Planit të Veprimit e administron Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS). Ky mekanizëm institucional mbledh dhe analizon periodikisht nga strukturat përgjegjëse rezultatet, problematikat e konstatuara dhe vlerëson progresin e zbatimit të objektivave të Strategjisë çdo 6 muaj dhe në bazë vjetore.

Në kuadër të monitorimit dhe zbatimit të Strategjisë Institucionale 2022-2025 dhe Planit të Veprimit, Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) ngritur me Urdhërin e Komisionerit nr. 231 datë 29.12.2023, ka hartuar raportin periodik 1-vjeçar të monitorimit të zbatimit të Strategjisë për vitin 2023, raport i cili publikohet në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Komisionerit

Nga monitorimi i arritjeve të objektivave të Strategjisë Institucionale 2022-2025, si dhe të aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit për vitin 2023 për secilin prej tyre, GMS-ja ka vërejtur se nga **31 masa** të parashikuara gjithsej për vitin 2023:

- 27 masa janë realizuar plotësisht;
- 4 masa janë në proces.

Përqindja e realizimit të masave sipas objektivave përkatës, për vitin 2023 është **87.1%** dhe realizimi i tyre konkretisht është si në vijim:

E DREJTA PËR INFORMIM

OBJEKTIVI 1: Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e të drejtës për informim në përputhje me standardet ndërkombëtare.

	Masa	Periudha	Realizimi	Komente
1.	Miratimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119, datë 14.09.2014 “Për të drejtën e informimit” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij	2023	I realizuar	Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 78, datë 21.09.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119 datë 14.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 152, datë 20.10.2023. https://qbz.gov.al/eli/fz/2023/152/aef1d92d-368e-4d13-b2ef-c9ac80977ba5
2.	Zbatimi efektiv i ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” si dhe miratimi i akteve nënligjore në zbatim të tij.	2023	I realizuar	Ligji nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, ka hyrë në fuqi në prill të vitit 2023. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 33/2022, Zyrës së Komisionerit iu ngarkua kompetenca e mbrojtjes, mbikëqyrjes dhe promovimit të këtij ligji dhe bazuar në Vendimin e Kuvendit të Republikës të Shqipërisë nr. 24/2023 ““Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”” janë bërë ndryshimet në strukturë dhe organigramë të Zyrës së Komisionerit ku janë parashikuar sektorët e rinj, bazuar edhe në kompetencat e shtuara. Specifikisht është shtuar Sektori i posaçëm për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik i cili ka si objekt shqyrtimin e ankesave të qytetarëve dhe/ose grupeve të interesit, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e parashikuara në ligjin për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik, si dhe ligjin për njoftim dhe konsultim publik si dhe kryerjen e hetimeve administrative dhe zhvillimin e seancave dëgjimore publike.

				<p>https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/Vendimi-nr-24-2023-kuvendi.pdf</p> <p>Gjatë kësaj periudhe, Zyra e Komisionerit në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 33/2022, ka vijuar punën për hartimin e udhëzimit të përbashkët për miratimin e modelit të licencës standarde në formatin elektronik, e cila përcakton kushtet e ripërdorimit të dokumenteve të sektorit publik.</p>
3.	Forcimi i kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit mbi zbatimin efektiv të kuadrit të modernizuar ligjor.	2023	I realizuar	<p>Forcimi i kapaciteteve është një nga proceset më të rëndësishme të çdo institucioni. Në zbatim të Planit Vjetor të Trajnimeve, punonjësit e Zyrës së Komisionerit kanë qenë pjesëmarrës në trajnimet e organizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA). Konferenca V Kombëtare “<i>E drejta për informim</i>”, është aktiviteti vjetor i zhvilluar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i cili gjatë vitit 2023 e organizoi atë në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Zyrën e Këshillit të Evropës (KiE) në Shqipëri.</p> <p>Ky takim i rëndësishëm, me pjesëmarrjen e stafit të Zyrës së Komisionerit dhe mbi 150 përfaqësuesve të autoriteteve publike qendrore e të varësisë, të pavarura, të sistemit të drejtësisë apo të vetëqeverisjes vendore, kishte në fokus vlerësimin e nivelit të zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit”.</p> <p>Me shumë interes nga të pranishmit u ndoq fjala e ekspertit të KiE, z. Cesare Pitea, i cili diskutoi mbi risitë e Konventës 205 “<i>Për aksesin në dokumente zyrtare</i>” (njohur ndryshe si Konventa e Tromsø), dokument që ka vendosur standarde bashkëkohore në këtë fushë jo vetëm për hapësirën evropiane. Pikë e rëndësishme gjatë Konferencës ishte prezantimi i portalit qeveritar për të dhënat e hapura <i>opendata.gov.al</i>, nga përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Kjo platformë përbën një nga detyrimet</p>

				që burojnë nga zbatimi i ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, që ka hyrë fuqi prej muajit maj 2023.
4.	Ofrimi i mbështetjes praktike për autoritetet publike mbi zbatimin e kuadrit të ri rregullator të fushës.	2023	I realizuar	<p>“Konferenca V Kombëtare “E drejta për informim – Hapje, Transparencë, Digjitalizim”, ishte aktiviteti i zhvilluar nga institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me pjesëmarrjen e mbi 150 përfaqësuesve të autoriteteve publike qendrore e të varësisë, të pavarura, të sistemit të drejtësisë apo të vetëqeverisjes vendore, ku u prezantua një panoramë e përmbushjes së detyrimeve të legjislacionit në këtë fushë në vitin e tij të 9-të të zbatimit, situatën e transparencës proaktive apo aksesin nga qytetarët dhe grupet e interesit në informacionin/dokumentacionin publik që prodhojnë ose disponojnë institucionet. Të pranishmit ndoqën dhe tema të dedikuara nga eksperti i Këshillit të Evropës i cili diskutoi mbi risitë e Konventës 205 “Për aksesin në dokumente zyrtare” (njohur ndryshe si Konventa e Tromsos), si dhe prezantimi i portalit qeveritar për të dhënat e hapura <i>opendata.gov.al</i>, nga përfaqësuesi i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.</p> <p>Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve ligjore në nëntor të vitit 2023, Zyra e Komisionerit ka vijuar me trajnimin individual të koordinatorëve për të drejtën e informimit si nëpërmjet takimeve pranë Zyrës ashtu dhe nëpërmjet konsulencave telefonike apo nëpërmjet komunikimit elektronik.</p>
OBJEKTIVI 2: Komunikimi proaktiv për konsolidimin e kulturës së transparencës të autoriteteve publike.				
1.	Forcimi i rolit të koordinatorit për të drejtën e informimit.	2023	I realizuar	Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ligjin nr. 78, datë 21.09.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119 datë 14.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 152, datë 20.10.2023.

				<p>Një nga çështjet më të rëndësishme që është adresuar në këtë dokument, është përcaktimi i saktë dhe konkret i përgjegjësisë për mospërbushjen e dispozitave të legjislacionit për të drejtën e informimit. Zyra e Komisionerit, nga ushtrimi i hetimeve administrative në autoritetet publike, ka konstatuar në shumë raste se përgjegjësia për mosdhënien e informacionit nuk ka qenë e drejtpërdrejtë e koordinatorit. Por ligji aktual njih si përgjegjës në procesin e trajtimit të kërkesës për informim vetëm këtë të fundit, i cili pavarësisht se i ka përbushur kompetencat, ngarkohet me përgjegjësi administrative për mosdhënien e informacionit. Adresimi i kësaj problematike ka për qëllim të qartësojë e të forcojë rolin e koordinatorit brenda strukturës së autoritetit publik. Ky përmirësim, kombinuar edhe me përfitimin e një shtese në pagë për natyrën e veçantë të punës të koordinatorit, do të ndikojë në rritjen e profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së nëpunësit përballë qytetarëve. Në vijim të sa më sipër Zyra e Komisionerit i është drejtuar DAP dhe MFE në cilësinë e institucioneve përgjegjëse, referuar pikës 2, 3 dhe shkronjës d) të pikës 4 të nenit 8, të Ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vend, lidhur me propozimin për përfitimin e një shtese page për natyrë të veçantë pune të koordinatorit për të drejtën e informimit, bazuar në pikat 4, 5 dhe 6 të nenit 10 të ligjit nr.. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.</p>
2.	Orientimi i autoriteteve publike në qartësimin e çështjeve me interes publik dhe rasteve të kufizimit të	2023	I realizuar	Zyra e Komisionerit ka organizuar disa trajnime me përfaqësues të autoriteteve publike ku është trajtuar në mënyrë të veçantë tema “e testit të interesit publik”, rasteve të kufizimit të dhënies së informacionit, sidomos për konceptin e konfidencialitetit dhe

	dhënies së informacionit, sidomos, përdorimin e konceptit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së te dhënave personale.			mbrojtjes së te dhënave personale. Konkretisht këto tema janë trajtuar në: Konferencën e V Kombëtare “E drejta për informim”, në ditët e Transparencës të zhvilluar në bashkëpunim me OSBE, në bashkitë Gjirokastër, Malësi e Madhe dhe Kavajë; në takimin e zhvilluar me rastin e Ditës Ndërkombëtare të të Drejtës për Informim me stafin e Bashkisë Tiranë me qëllim për të nxitur transparencën, llogaridhënien, përgjegjshmërinë dhe mirëqeverisjen. Në këtë takim ndërgjegjësues ishin të pranishëm nëpunës të njësisë më të madhe të vetëqeverisjes vendore në vend; etj.
3.	Përfshirja në Indeksin e Transparencës të numrit më të madh të autoriteteve publike në nivel qendror dhe të varësisë.	2023	I realizuar	Zyra e Komisionerit ka realizuar për të katërtin vit radhazi hartimin e 2 Raporteve të Indeksit të Transparencës për vitin 2023: Indeksin e Transparencës për Institucionet Qendrore dhe të Varësisë si dhe Indeksin e Transparencës së Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore. Në hartimin e këtyre 2 raporteve, Zyra e Komisionerit është përpjekur të sjell një panoramë më të gjerë të nivelit të transparencës së autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë, duke përfshirë në këto indekse 315 autoritete publike, 211 që u analizuan në vitin 2022, si dhe duke analizuar 10 kategori informacioni, përkundrejt 8 kategorive të mëparshme. Gjatë vitit 2023, Zyra e Komisionerit në kuadër të detyrave dhe kompetencave të përcaktuar me ligj, ka vijuar monitorimin e programeve të transparencës të publikuar në faqen zyrtare të të gjitha autoriteteve publike, si dhe monitorimin e publikimit dhe përditësimit të regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve. Në total gjatë vitit 2023 janë monitoruar 332 autoritete publike ku rezulton se të gjitha kanë caktuar koordinatorin për të drejtën e informimit dhe të dhënat e koordinatorëve janë përditësuar dhe në portalin pyetshtetin.al, 306 autoritete publike kanë publikuar programin e transparencës dhe përditësuar me informacion ndërsa

				regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve është përditësuar nga 329 koordinator për të drejtën e informimit.
4.	Verifikimi i nivelit të transparencës së institucioneve publike qendrore, të varësisë dhe atyre të vetëqeverisjes vendore	2023	I realizuar	<p>U verifikua niveli i transparencës proaktive në 240 institucione qendrore: “Institucione Qendrore” (përfshirë institucionet kushtetuese dhe ato qendrore të krijuar me ligj të veçantë), “Institucionet e varësisë”, “Institucionet të Sistemit të Drejtësisë”, (të ndarë në gjykata dhe prokurori), si dhe “Institucione të tjera” (përfshirë IAL, sh.a, etj). Sistemi i matjes i përdorur në këtë monitorim i referohet 10 treguesve kryesorë të cilët bëjnë vlerësimin objektiv të nivelit funksional të transparencës proaktive të autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë. Në përfundim të monitorimit të transparencës proaktive vërejmë se 91 autoritete publike qendrore dhe të varësisë janë klasifikuar me transparencë proaktive të lartë dhe në semafor janë shënuar me dritë të gjelbër, 126 autoritete publike janë klasifikuar me transparencë proaktive mesatare dhe në semafor janë shënuar me dritë të bardhë; 21 autoritete publike janë klasifikuar me transparencë proaktive të ulët dhe në semafor janë shënuar me dritë të verdhë; 4 autoritete publike janë klasifikuar me transparencë proaktive të pamjaftueshme dhe në semafor shënohen me dritë të kuqe. Në krahasim me gjetjet e vitit të kaluar, mund të veçohet rritja e transparencës tek autoritetet publike me semafor të gjelbër nga 12% në vitin e kaluar në 37% për këtë vit çka shënon dhe përmirësimin më të dukshëm të bërë nga të gjithë vitet e kaluara, në transparencën proaktive të autoriteteve publike qendrore dhe të varësisë.</p> <p>Në këtë monitorim janë përfshirë 61 njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore dhe 12 Këshillat e Qarkut. Për matjen e transparencës së Këshillave të Qarkut janë përdorur të njëjtët indikatorë të përdorur për të matur transparencën e Institucioneve Qendrore dhe të varësisë. Në</p>

				<p>monitorimin e kryer për Njësitë bazë të Vetëqeverisjes Vendore është përdorur sistemi i matjes së 10 treguesve kryesorë.</p> <p>Në përfundim të monitorimit të transparencës proaktive vërejmë se 21 njësi të vetëqeverisjes vendore janë klasifikuar me transparencë proaktive të lartë dhe në semafor janë shënuar me dritë të gjelbër, ndërsa 43 institucione të njësive të vetëqeverisjes vendore janë klasifikuar me transparencë proaktive mesatare dhe në semafor janë shënuar me dritë të bardhë; 6 njësi të vetëqeverisjes vendore janë renditur me transparencë proaktive të ulët dhe në semafor janë shënuar me dritë të verdhë; vetëm 3 njësi të vetëqeverisjes vendore janë klasifikuar me transparencë proaktive shumë të ulët dhe në semafor shënohen me dritë të kuqe. Në krahasim me gjetjet e vitit të kaluar, kemi konstatuar rritje të transparencës tek njësitë e vetëqeverisjes vendore me semafor të gjelbër nga 21 % në vitin e kaluar në 29 % për këtë vit çka shënon dhe përmirësimin më të dukshëm të bërë nga të gjithë vitet e kaluara, në transparencën proaktive të autoriteteve publike të njësive të vetëqeverisjes vendore.</p>
<p>OBJEKTIVI 3: Bashkëpunimi me qytetarët dhe grupet e interesit për njohjen e kuadrit të modernizuar ligjor dhe të drejtat që u burojnë nga legjislacioni në fushën e të drejtës për informim.</p>				
1.	Zhvillimi i iniciativave ndërgjegjësuese me qëllim njohjen e publikut, shoqërisë civile, grupet e interesit dhe median me kuadrin e ri rregullator.	2023	I realizuar	<p>Gjatë vitit 2023, Zyra e Komisionerit zhvilloi disa takime në kuadër të zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit:</p> <p>Me tematikën “E drejta e informimit në Shqipëri: vendimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, u zhvillua forumi për trajtimin e veprimtarisë institucionale nga këndvështrimi i studimeve akademike. Si nismë e mbështetur nga Zyra e Komisionerit, ky aktivitet u mbajt në kuadër të projektit të përbashkët të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), programit Ekspertiza Hulumtuese nga Diaspora</p>

			<p>Akademike (READ) dhe Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Tiranës. Në këtë forum ishin të pranishëm përfaqësues nga bota akademike, shoqëria civile, si dhe koordinatorë për të drejtën e informimit të institucioneve qendrore e të pavarura.</p> <p>Zyra e Komisionerit bashkëpunoi me disa organizata dhe media investigative në zhvillimin e projektit “Mbështetje për pjesëmarrjen, përgjeshmërinë dhe fuqizimin e shoqërisë civile”, i financuar nga Bashkimi Evropian. Ky projekt u zhvillua gjatë muajit dhjetor 2023 në 6 takime, në qytetet e Elbasanit, Korçës, Tepelenës, Gjirokastrës, Shkodrës dhe Lezhës, ku të pranishëm ishin përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile apo grupeve të interesit dhe qytetarë. Në fokus ishte nxitja e ndërgjegjësimit dhe promovimi i kuadrit të ri rregullator i së drejtës për informim, si dhe rëndësia e procesit të konsultimit publik në kuadër të kontrollit dhe pjesëmarrjes në qeverisje.</p> <p>https://www.idp.al/2023/06/01/zbatimi-i-legjislacionit-per-te-drejtjen-e-informimit-dhe-ai-per-mbrojtjen-e-te-dhenave-personale-takime-ne-gjirokaster/</p> <p>https://www.idp.al/2023/09/21/zbatimi-i-legjislacionit-per-te-drejtjen-e-informimit-dhe-ai-per-mbrojtjen-e-te-dhenave-personale-takime-ne-malesine-e-madhe/</p> <p>https://www.idp.al/2023/10/31/garantimi-i-te-drejtave-te-qytetareve-takime-ne-bashkine-kavaje/</p>	
2.	Zhvillimi i trajnimeve për zbatimin e të drejtës për	2023	I realizuar	Gjatë vitit 2023, Zyra e Komisionerit zhvilloi disa takime me universitete publike dhe private, duke trajnuar studentë dhe staf

	informim me fokus brezin e ri në bashkëpunim me institucione të arsimit të lartë në gjithë vendin.		<p>akademik/administrativ i trajnuar, në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit.</p> <p>Gjithashtu në kuadër të “Javës së integritetit”, Zyra e Komisionerit, së bashku me Ministrinë e Drejtësisë, organizuan një forum diskutimi në mjediset e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.</p> <p>https://www.idp.al/2023/11/24/takim-me-studente-te-fd-te-informuar-e-ndergjegjesuar-per-respektimin-e-te-drejtave-te-qytetareve/</p> <p>https://www.idp.al/2023/06/29/forum-per-rolin-e-zyres-se-komisionerit-ne-promovimin-e-te-drejtës-per-informim/</p>
3.	Dhënie kontributi me ekspertizë teknike që u nevojiten aktorëve të shoqërisë civile, për të përçuar më tej rolin e tyre si <i>watchdog</i> të transparencës dhe aksesit në informacion	2023	<p>Në vijim të traditës së Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale u zhvillua takimi vjetor me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe medias investigative. Aktiviteti kishte për qëllim të bënte një bilanc të veprimtarisë së zhvilluar në këtë fushë përgjatë vitit 2023, risitë e ndryshimeve në legjislacionin për të drejtën e informimit, si dhe shtimin e përpjekjeve për konsolidimin e kulturës së përgjegjshmërisë e të transparencës së autoriteteve publike.</p> <p>Gjithashtu, Zyra e Komisionerit prezantoi ndryshimet dhe përmirësimet në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, që kanë hyrë në fuqi në fillim të muajit nëntor 2023, proces ky i konsultuar gjerësisht me shoqërinë civile, organizatat e medias investigative dhe grupet e intertesit. Këto risi kanë përmirësuar akoma edhe më shumë standardet dhe praktikatat kombëtare në këtë fushë, duke i sjellë ato gjithnjë e më pranë atyre më bashkëkohore evropiane e ndërkombëtare. Të pranishmit vlerësuan punën dhe qasjen e Zyrës së</p>

				Komisionerit dhe trajtuan çështje e problematika konkrete që janë të ndjeshme në veprimtarinë e tyre. Nga ana tjetër, u diskutua për shfrytëzimin e të gjitha mundësive për të ndikuar në rritjen e edukimit dhe ndërgjegjësimit të autoriteteve publike në përmbushjen e detyrimeve për ushtrimin plotë të të drejtës për informim.
4.	Realizimi dhe publikimi periodik në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit të materialeve informuese dhe përdorimi i platformave të ndryshme komunikuese.	2023	I realizuar	Gjatë vitit 2023, Zyra e Komisionerit hartoi dhe publikoi materiale ndërgjegjësuese për të drejtën e informimit si <i>Newsletter</i> mujor “E drejta për informim”, e hartuar dhe publikuar çdo muaj https://www.idp.al/newsletter-2023/ Si dhe revistën nr. 15/2023 “Informim dhe Privatësi” https://www.idp.al/revista/
OBJEKTIVI 4: Zhvillimi dhe zgjerimi i marrëdhënieve ndërkombëtare brenda komunitetit global rregullator të së drejtës për informim.				
1.	Dhënia e kontributit në cilësinë e përfaqësuesit në Këshillin e Palëve të Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”.	2023	I realizuar	Për vitin 2023, Zyra e Komisionerit plotësoi pyetësin mbi masat legislative dhe masat e tjera për zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumente zyrtare”. Gjatë vitit 2022, Shqipëria miratoi ligjin nr. 45/2022, datë 28.04.2022 “Për ratifikimin e Konventës 205 të Këshillit të Evropës “Për aksesin në dokumenta zyrtare”. Zyra e Komisionerit është caktuar si përfaqësuese e vendit në Këshillin e Palëve të Konventës dhe ka përfaqësuar shtetin shqiptar në mbledhjen e radhës e cila u zhvillua online gjatë muajit tetor 2023.
2.	Veprimtari aktive në grupet/bordet e punës të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve për të Drejtën e Informimit (ICIC), duke punuar ngushtë me partnerët dhe institucionet homologe.	2023	I realizuar	Gjatë muajit tetor 2023, Këshilli i Evropës organizoi takimin me temë “ <i>E drejta për informim për dokumentet zyrtare, standardet e Këshillit të Evropës (KiE) – The right to access State-held information, Council of Europe standards</i> ”, e cila u mbajt në Varshavë, në kuadër të Konferencës për të Drejtat e Njeriut të Varshavës 2023 (<i>Human Dimension Conference</i>) të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE).

			<p>Zyra e Komisionerit është anëtare e zgjedhur e Komitetit Ekzekutiv të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) dhe ka marrë pjesë në 8 takime online të zhvilluara përgjatë vitit.</p> <p>Gjithashtu Zyra e Komisionerit ka marrë pjesë në 9 takimet online të Komitetit të Planifikimit për edicionin e 14 të Konferencës si anëtare e saj. Ndërkohë janë zhvilluar edhe 2 takime të Komitetit të Planifikimit për edicionin e 15 të konferencës e cila do të organizohet nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë datave 3-5 qershor 2024 në Tiranë. Takimet e Komitetit të Planifikimit për edicionin e 15 të Konferencës bashkëdrejtohen nga Zyra e Komisionerit dhe Sekretariati i ICIC (Meksikë –INAI).</p> <p>Zyra e Komisionerit është anëtare në 2 grupe pune të ICIC dhe konkretisht në grupin e punës <i>“Transparency by Design”</i> dhe atë <i>“Training”</i>. Në kuadër të aktivitetit të grupeve të punës , Zyra e Komisionerit ka plotësuar dy pyetësor gjithëpërfshirës në lidhje me konceptet e transparencës dhe aktivitetet e autoriteteve rregullatore si dhe në lidhje me nevoja për trajnim të autoriteteve.</p> <p>Zyra e Komisionerit mori pjesë në edicionit të 14-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC), zhvilluar në datat 19-21 qershor 2023, të organizuar nga Komisioneri i Filipineve me temë <i>“Ndërveprimi mes shteteve: Roli global i të drejtës për informim për konsolidimin e demokracisë, gjithëpërfshirjen dhe zhvillimin”</i>. Ky është aktiviteti vjetor botëror që mbledh komunitetin e profesionistëve të fushës së aksesit në informacionin me karakter</p>
--	--	--	--

				<p>publik, në fokus të të cilit është forcimi i transparencës dhe integritetit të autoriteteve publike.</p> <p>Përgjatë 2 ditëve të punimeve të Sesionit të Hapur pjesëmarrësit diskutuan për çështje të rëndësishme, si: forcimin e veprimtarisë së institucioneve mbikëqyrëse të të drejtës për informim; aksesin në informacion si një përgjigje ndaj sfidave moderne të demokracisë, apo rolin e kësaj të drejte në nxitjen e zhvillimit ekonomiko-shoqëror. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është përzgjedhur si organizatore e edicionit të 15-të të Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (<i>International Conference of Information Commissioners-ICIC</i>) dhe do të mbahet në Tiranë në data 3-5 qershor 2024 me temë <i>Empowering Individuals Through Access to Information: Ensuring Transparency and Inclusivity in an Interconnected world</i>". Me votim unanim anëtarësia e ICIC, gjatë punimeve të Sesionit të Mbyllur të Konferencës së Meksikës, propozimin e Komitetit Ekzekutiv.</p> <p>Besimi për organizimin e këti aktiviteti është një përgjegjësi për Zyrën e Komisionerit, për promovimin e kulturës së transparencës dhe mirëqeverisjes në Shqipëri dhe më gjerë, në rajonin tonë.</p>
3.	Zgjerim i bashkëpunimit me autoritetet homologe për shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira.	2023	I realizuar	<p>Zyra e Komisionerit, në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare, ka marrë pjesë rregullisht në aktivitete, takime, trajnime apo seminare të organizuara nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komiteti Konsultativ i Konventës 205 të Këshillit të Evropës; • Komiteti Ekzekutiv i ICIC; • Grupet Ndërkombëtare të Punës të ICIC-së "<i>Transparency by design</i>" dhe "<i>Training</i>";

				<ul style="list-style-type: none"> • Konferenca me rastin e 28 Shtatorit – Ditës Ndërkombëtare për të Drejtën e Informimit e organizuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën (UNESCO) dhe Universiteti i Oksfordit në Britani; • Takimin e Punës të Rasteve të Veçanta (<i>Case Handling workshop-CHW</i>). Ky takim u organizua nga Autoriteti Federal për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të Gjermanisë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga mbi 20 institucione homologe evropiane. <p>Në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Zyrës së Komisionerit dhe Agjencisë për Informim dhe Privatësi të Kosovës (AIP), u zhvillua takimi i dytë me pjesëmarrjen e stafeve përkatës, që kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit profesional, shkëmbimin/diskutimin e rasteve nga praktika administrative, si dhe planifikimin e nismave për të ardhmen.</p> <p>Aktiviteti u mbajt përgjatë dy ditëve, ku sipas agjendës u prezantua kuadri rregullator dhe veprimtaria e AIP, si dhe u trajtuan detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave përbërëse të autoritetit të Kosovës. Në këtë këndvështrim, Zyra e Komisionerit u angazhua në ofrimin e asistencës për zbatimin e kuadrit rregullator në fushën e të drejtës për informim, kryesisht, për hartimin/përditësimin e Programit të Transparencës, duke marrë në konsideratë përvojën e akumuluar në këtë drejtim në Shqipëri.</p>
--	--	--	--	---

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

OBJEKTIVI 1: Arritja e standardeve më të larta rregullatore për të forcuar mbrojtjen e të dhënave personale në epokën digjitale.

Masa		Periudha	Realizimi	Komente
1.	Miratimi i projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i përafuar me <i>acquis</i> të BE në këtë fushë dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.	2023	Në proces	Projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale i përafuar me Rregulloren e BE-së 2016/679 dhe Direktivën 2016/680 të BE-së, vijon të jetë në fazën e finalizimit të miratimit të tij. Për shkak të rëndësisë që mbart ky projektligj si një ligj parakusht për integrimin e vendit, ka qënë i domosdoshëm edhe kontributi i Komisionit Evropian. Në këtë kuadër, gjatë vitit 2023 u zhvilluan një sërë takimesh të përbashkëta midis ekspertëve të Komisionit Evropian, Delegacionit të BE-së në Tiranë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (<i>më tej “Zyra e Komisionerit”</i>) me qëllim diskutimin dhe dakortësinë e komenteve të Komisionit Evropian. Ndërkohë, Zyra e Komisionerit vijon të ketë një rol aktiv në këtë proces pasi vlerëson se miratimi sa më shpejt i këtij projektligji është një domosdoshmëri.
2.	Miratimi i projektligjit “Për krijimin e Regjistrimit të Komunikimeve Tregtare të pa kërkuara”.	2023	Në proces	Në proces
3.	Promovimi i qasjes së re të kontrolluesëve dhe përpunuesëve në procesin e përpunimit të të dhënave personale me qëllim garantimin më efektiv të sigurisë së informacionit.	2023	Në proces	Përmbushja e këtij objektivi lidhet me miratimin e ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale. Projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale i përafuar me Rregulloren e BE-së 2016/679 dhe Direktivën 2016/680 të BE-së, vijon ende të jetë në proces.

4.	Nxitja e kontrolluesve publik e privat për t'iu drejtuar Zyrës së Komisionerit për dhënien e mendimeve për projekt-aktet, ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me të dhënat personale, si dhe projektet që kërkohen të zbatohen nga kontrolluesit vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë.	2023	I realizuar	<p>Zyra e Komisionerit është angazhuar në dhënien e mendimeve për projektaktet ligjore e nënligjore në raport me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, institucioni ka dhënë mendim për 10 projektligje, 9 projektvendime. Në këtë frymë, janë dhënë edhe 30 opinione për çështje/projekte-akte të paraqitura nga kontrollues publik dhe privat.</p> <p>Vlerësojmë se këto shifra janë tregues të rritjes së ndërgjegjësimit të institucioneve për sa i përket zbatimit të detyrimit të parashikuar në germën a, të nenit 31, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar për të konsultuar projekt-aktet që kanë në objektin e tyre edhe përpunimin e të dhënave personale.</p> <p>Këto mendime nuk janë aspak thjesht pjesë të një procesi burokratik e procedural, por në fakt janë një parakusht themelor për të arritur ekuilibrin e duhur ndaj numrit gjithnjë në rritje të ligjeve dhe rregulloreve që përfshijnë përpunimin e të dhënave personale.</p>
OBJEKTIVI 2: Rritja e kapaciteteve institucionale në kuadër të përmirësimeve ligjore, me fokus të veçantë sistemet e sigurisë së menaxhimit të informacionit (SMSI).				
1.	Propozimi i ndryshimeve strukturore të Zyrës së Komisionerit në funksion të kompetencave dhe detyrave të reja që burojnë nga legjislacioni i ri për mbrojtjen e të dhënave personale.	2023	I realizuar	<p>Me Vendimin e Kuvendit të Republikës të Shqipërisë nr. 24/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 86/2018 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”” janë bërë ndryshimet në strukturë dhe organigramë të Zyrës së Komisionerit ku janë parashikuar sektorët e rinj, bazuar edhe në kompetencat e shtuara.</p> <p>https://www.idp.al/wp-content/uploads/2016/10/Vendimi-nr-24-2023-kuvendi.pdf</p>

2.	Pjesëmarrja e stafit në iniciativat dhe rrjetet teknologjike ndërkombëtare dhe evropiane me qëllim përmirësimin e aftësive të tyre në këtë drejtim.	2023	I realizuar	<p>Inspektor te DPMDP, kanë marr pjesë në punimet e Grupit Ndërkombëtar i Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Teknologji (IWGDPT) i cili vëzhgon tendencat dhe zhvillimet në sektorin teknologjik, si “<i>të dhënat e mëdha</i>”, “<i>Interneti i gjërave</i>” ose “<i>inteligjenca artificiale</i>”. Grupi zhvillon rekomandime dhe udhëzime për përdorimin e këtyre teknologjive në një mënyrë që është në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave.</p> <p>Grupi përbëhet nga pjesëmarrës nga autoritetet mbikëqyrëse të mbrojtjes së të dhënave, agjencitë qeveritare, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat joqeveritare, si dhe nga kërkimi dhe shkenca.</p>
3.	Identifikimi dhe garantimi i sigurisë teknike në kontrollues publikë dhe privatë me qëllim ruajtjen e konfidencialitetit, integritetit, disponueshmërinë dhe besueshmërinë e sigurisë së informacionit në procesin e përpunimit të të dhënave personale.	2023	I realizuar	<p>Zyra e Komisionerit ka konstatuar në vazhdimësi një përpunim në rritje të të dhënave personale nga kontrolluesit publik dhe privat përmes sistemeve TIK. Kontrollat dhe mbikëqyrja e realizuar nga Zyra e Komisionerit, në zbatim të kompetencave të përcaktuara në nenet 30 dhe 31 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kanë patur në fokus të tyre verifikimin e respektimit të parimeve dhe kriterëve ligjore për përpunimin e të dhënave personale, si dhe verifikimin e masave teknike dhe organizative për parandalimin e përhapjes së paligjshme të të dhënave të subjekteve të të dhënave, në përputhje me nenet, 5, 6, 12 - 15, 18 - 20, 27 dhe 28 të ligjit në fjalë.</p> <p>Kontrolluesit janë të detyruar të marrin masa teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit të tyre, në përputhje me nenet 27 dhe 28 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Këto dispozita parashikojnë detyrimin e çdo Kontrolluesi për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur</p>

			<p>përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.</p> <p>Gjithashtu, përveç dispozitave të sipërpërmendura të ligjit, grupi i inspektimit është bazuar edhe në dispozitat detyruese të akteve nënligjore të nxjerra nga Komisioneri, përfshirë, veçanërisht, Udhëzimet nr. 19, 47 dhe 48 të Komisionerit, të cilat përmbajnë detyrimet e Kontrolluesve lidhur me marrëdhëniet me Përpunuesit përkatës, si dhe për krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>SMSI bazohet në identifikimin, analizimin dhe në zbutjen e rreziqeve ndaj sigurisë së të dhënave personale duke marrë parasysh sistemet TIK për përpunimin e të dhënave, format manuale të përpunimit, sigurinë fizike të mjediseve, personelit dhe pajisjeve, duke përcaktuar në standardet TIK si vijon: (i) “Konfidencialitetin”, duke siguruar që të dhënat personale të jenë të aksesueshme vetëm për personat e autorizuar; (ii) “Integritetin”, duke siguruar që të dhënat të jenë të sakta, të plota dhe duke ruajtur metodat e përpunimit të tyre; (iii) “Disponueshmërinë”, duke siguruar aksesin e përdoruesit të autorizuar në të dhënat dhe në sistemet e përpunimit; (iv) “Konfidencialitetin”, duke garantuar që çdo aktivitet/veprim mbi të dhënat, i sistemeve TIK dhe personelit të përdorur për përpunimin e tyre, është i gjurmueshëm dhe i kontrollueshëm.</p> <p>Gjithashtu, është e nevojshme që SMSI të përfshijë një set rregullash dhe dokumentesh detyruese për Kontrolluesit, të tilla si Analizën e Ndikimit në të Dhënat Personale, Politikën e Sigurisë së Informacionit, Kontrollin e sistemit të arkivimit të të dhënave, etj., si dhe sigurinë fizike të ambienteve, të personelit dhe pajisjeve (platformave) TIK.</p>
--	--	--	--

4.	Krijimi i Rrjetit të nëpunësve për mbrojtjen e të dhënave personale në sektorin publik dhe privat dhe promovimi i dialogut me ta.	2023	I realizuar	Gjatë këtij viti i është kushtuar rëndësi rolit të Nëpunësve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (DPO) pranë kontrolluesve, që është element i rëndësishëm edhe në referim të Rregullores së Bashkimit Evropian 679/2016 (GDPR). Personi i kontaktit është një hallkë në procesin e garantimit të sigurisë së përpunimit të të dhënave personale në zbatim të nenit 27 të ligjit dhe Udhëzimit të Komisionerit nr. 47, datë 14.09.2019 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”. Është krijuar dhe është në proces konsolidimi, Regjistri i Nëpunësve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjatë vitit 2023, dërguan dhe konfirmuan mbi caktimin e DPO 328 kontrollues të sektorit publik, dhe 107 të kontrollues në sektorit privat duke përfshirë fushat e telekomunikacionit, bankar e financiar, sigurimeve, shëndetësisë, arsimit, turizmit dhe shërbimeve të ndryshme. Regjistri i DPO mbetet në proces përditësimi të vazhdueshëm.
OBJEKTIVI 3: Rol aktiv në ndërgjegjësimin dhe promovimin e të drejtave të qytetarëve me fokus, edhe edukimin e brezit të ri.				
1.	Organizime periodike të trajnimeve, workshop-e me qëllim rritjen e aftësive të kontrolluesve/përpunuesve në zhvillimin me përgjegjshmëri të proceseve përpunuese të të dhënave personale të qytetarëve.	2023	I realizuar	Gjatë vitit 2023, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me ASDO, ka zhvilluar disa takime në kuadër të projektit “Siguria kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave”. https://www.idp.al/2023/03/09/mbrojtja-e-te-dhenave-personale-ne-sistemin-shendetesor-ne-kuader-te-projektit-me-organizaten-asdo/ https://www.idp.al/2023/09/11/standarde-te-larta-per-mbrojtjen-e-te-dhenave-personale/ https://www.idp.al/2023/01/24/epoka-digjitale-dhe-mbrojtja-e-te-dhenave-personale-ne-sektorin-bankar/

				https://www.idp.al/2023/03/31/mbrojtja-e-te-dhenave-personale-ne-sektorin-e-pasurive-te-palujtshme/
2.	Promovimi i legjislacionit të ri të fushës në sistemin arsimor të vendit, me programe të dedikuara për të gjitha grupmoshat, veçanërisht, për fëmijët dhe të rinjtë.	2023	I realizuar	Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Qendrën Shqiptare për Zhvillim të Qendrushëm (ASDO), me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane në Tiranë, organizuan takime ndërgjegjësuese në institucione të arsimit parauniversitar në kuadër të projektit “Siguria kibernetike dhe mbrojtja e të dhënave”. Këto takime u zhvilluan në shkollat 9-vjeçare publike “1 Maji” e “Ali Demi” dhe në atë jopublike “Elina”. Të pranishmit u njohën me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale, ushtrimin e të drejtave të tyre, apo dhe me këshilla praktike për përdorimin e sigurt të mjedisit digjital/kibernetik. Për nxënësit e mësuesit pjesëmarrës në këto aktivitete ndërgjegjësuese, u prezantua loja “Happy onlife”, nëpërmjet të cilës nxitet i menduari kritik i të rinjve, sidomos, për sjelljet që ata duhet të përshtasin gjatë përdorimit të rrjeteve sociale https://www.idp.al/2023/06/20/njohje-dhe-ndergjegjesim-nga-nxenesit-per-mbrojtjen-e-te-dhenave-personale/
3.	Përcjellja e njohurive të thelluara akademike për shtimin e numrit të ekspertëve/profesionistëve në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë, Shkollën e Magjistraturës dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.	2023	I realizuar	Në bashkëpunim me ASPA, janë zhvilluar 12 trajnime online për shkëmbimin e përvojave më të mira në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe trajtimin e rasteve konkrete. Pjesë e takimeve ishin rreth 360 nëpunës civilë të kategorive të ndryshme. Gjithashtu ka vijuar bashkëpunimi edhe me Shkollën e Magjistraturës ku zyrtarët me të lartë të Zyrës së Komisionerit kanë mbajtur leksione të dedikuara për magjistratët.

4.	Hartimi i materialeve ndërgjegjësuere për promovimin e kulturës në ushtrimin të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale nga qytetarët.	2023	I realizuar	<p>Në kuadër të krenimit të 28 janarit Ditës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së të Dhënave Personale Zyra e Komisionerit, përgatiti një video dhe një poster elektronik. Këto materiale ndërgjegjësuere iu shpërndanë autoriteteve (kontrollues) publike qendrore e të varësisë, të pavarura apo të vetëqeverisjes vendore për t'u publikuar në faqet zyrtare të internetit, si dhe subjekteve mediatike publike e private për t'u transmetuar në kanalet audiovizuale.</p> <p>Njëkohësisht, Zyra e Komisionerit përgatiti dhe shpërndau në platformat/rrjetet sociale një poster me fokus të rinjtë për ndërgjegjësimin e tyre në përdorimin e sigurt të internetit.</p> <p>Gjithashtu, në bashkëpunim me Kolegjin Universitar të Biznesit zhvilluan një takim në formën e një leksioni të hapur. Të pranishëm ishin studentë dhe staf akademik e administrativ nga ky institucion i arsimit të lartë jo publik. Nëpërmjet edhe shembujve nga praktika, të pranishmit u njohën në tërësi me parimet dhe kriteret; të drejtat e qytetarëve; detyrimet e kontrolluesve/përpunuesve për marrjen e masave tekniko-organizative; sigurinë e të dhënave apo sfidat kryesore në këtë fushë. Duke iu përgjigjur interesit të të pranishmëve, u ofruan këshilla praktike lidhur me sjelljen e individit në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale, ndërsa u vlerësua se përgjegjshmëria e kontrolluesve/përpunuesve, si në sferën publike, ashtu edhe në atë private, do të rriste cilësinë e shërbimeve, sigurinë dhe transparencën e tyre.</p> <p>https://www.idp.al/wp-content/uploads/2023/08/revista_idp_nr_15_2023_compressed.pdf</p>
----	---	------	-------------	---

OBJEKTIVI 4: Forcimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë për shkëmbimin e përvojave më të mira, me fokus risitë që sjell zbatimin i legjislacionit të harmonizuar me *acquis* të BE.

1.	Zgjerimi i bashkëpunimit me autoritetet homologe dhe/ose organizmat ndërkombëtare për projekte në kuadër të shkëmbimit të praktikave/standardeve më të mira në këtë fushë	2023	I realizuar	Gjatë vitit 2023 u zhvillua vizita studimore, për hartimit modelit të Raportit Vjetor, në bashkëpunim me Oficerin e Mbrojtjes së të Dhënave në Eurojust, nëpërmjet instrumentit TAIEX. Vizita studimore dyditore u mbajt në Hagë, Hollandë ku morën pjesë Inspektorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave Personale e Zyrës së Komisionerit, si dhe një përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme. Takimet dhe prezantimet e mbajtura në këtë aktivitet u zhvilluan me përfaqësues nga institucioni i Eurojust, në bashkëpunim me përfaqësuesit e Autoritetit Holandez të Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Gjithashtu, në takimin me Eurojust mori pjesë Prokurori Ndërlidhës i Republikës së Shqipërisë, i mandatuar pranë këtij institucioni.
2.	Forcimi i kapaciteteve administrative në shqyrtimin e praktikave në lidhje me transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale.	2023	Në proces	Në proces
3.	Konsolidimi i marrëdhënieve, shkëmbimit të eksperiencave dhe njohurive praktike në kuadër të ligjit nr. 113/2018 "Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it".	2023	I realizuar	Gjatë vitit 2023 u zhvillua vizita studimore, për hartimit modelit të Raportit Vjetor, në bashkëpunim me Oficerin e Mbrojtjes së të Dhënave në Eurojust, nëpërmjet instrumentit TAIEX. Vizita studimore dyditore u mbajt në Hagë, Hollandë ku morën pjesë Inspektorë nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave Personale e Zyrës së Komisionerit, si dhe një përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme. Takimet dhe prezantimet e mbajtura në këtë aktivitet u zhvilluan me përfaqësues nga institucioni i Eurojust, në bashkëpunim me përfaqësuesit e Autoritetit Holandez të Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Gjithashtu, në takimin me Eurojust mori

				<p>pjesë Prokurori Ndërlidhës i Republikës së Shqipërisë, i mandatuar pranë këtij institucioni.</p> <p>Në këtë drejtim, është kontaktuar me Prokurorinë e Përgjithshme dhe prokuroritë e rretheve gjyqësore, Ministrinë e Drejtësisë dhe aktorët e tjerë të përfshirë në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Zyra e Komisionerit ka filluar zhvillimin e hetimeve administrative (monitoruese) pranë prokurorive me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të fushës dhe detyrimeve që burojnë për mbrojtjen e të dhënave duke përfshirë, Prokurorinë Lezhë, Prokurorinë Elbasan, Prokurorinë Tiranë si dhe Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK).</p>
4.	Pjesëmarrje aktive në forume e iniciativa për promovimin e dialogut ndërkombëtar për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë.	2023	I realizuar	<p>Asambleja Globale e Privatësisë (GPA), aktiviteti më i rëndësishëm vjetor i fushës, zhvilloi punimet e edicionit të 45-të në datat 16-20 tetor 2023. Me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga 169 autoritete anëtare e vëzhguese, nga shoqëria civile, bota akademike, grupet e interesit, media, etj, takimi u organizua nga Autoriteti i Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Bermudas (OPC), nën moton “Valë, Dallgë, Rryma”. Gjatë punimeve të Sesionit të Mbyllur u miratuan disa dokumente, të cilat do të nxisin forcimin e bazës rregullore në këtë fushë</p> <p>Zyra e Komisionerit, në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare, ka marrë pjesë rregullisht në aktivitete, takime, trajnime apo seminare të organizuara nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Komiteti Konsultativ i Konventës 108 të Këshillit të Evropës (T-PD); ○ Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave (EDPB); ○ Konferenca Evropiane e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (ECDPA);

			<ul style="list-style-type: none">○ Seminari i Shqyrtimit të Rasteve Praktike (Case Handling Workshop) të Konferencës Evropiane;○ Grupi Ndërkombëtar i Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Teknologji (Grupi i Berlinit);○ EUROJUST. <p>https://www.idp.al/aktivitete-nderkombetare/</p>
--	--	--	---